



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VESHTRISË - VUSHTRRI

DI Nr. / Dn. 214/16

No. Iq. / Dn. si - 22 -

Data / Data e 27. 10. 2016

VUSHTRRI - VUSHTRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCES VERBAL
NGA MBLEDHJA E VIII-të E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRISË, MBAJTUR MË 29 SHTATOR 2016

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, nënkryetari i komunës përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – në hapjen e punimeve të mbledhjes së kuvendit, njoftoi se anëtarja e kuvendit znj. Fatime Haziri ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtares së kuvendit pasi që ajo është angazhuar në një vend tjetër të punës. Pastaj në kuadër të prezantimit të rendit të ditës propozoi dy pika shtesë për futje në rend të ditës dhe atë Propozim-vendimin lidhur me ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, si dhe opinionin lidhur vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit për autorizimin e kryetarit të komunës për lidhjen e marrëveshjes mes Komunës së Vushtrrisë dhe spitalit të qytetit me çka niveli qendror ka konstatuar se ky vendim nuk është në pajtim me ligjin dhe i njëjti duhet të shfuqizohet.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – kërkoi nga kuvendi që në kuadër të rendit të ditës të futet edhe kërkesa për ofrimin e ndihmës financiare për shërim të Enis Rashicës, i cili vuan nga një sëmundje në zemër dhe i cili duhet t'i nënshtrohet një operacioni në Austri, ku shumë e mjeteve për këtë operacion në vlerë prej 70% e ka siguruar Ministria e Shëndetësisë, kurse nga komuna ka kërkuar një shumë të mjeteve financiare prej 7000€. Pastaj ai sqaroi se kërkesa e apostrofuar më lartë më herët i është adresuar kryetarit të komunës, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe KPF-së, andaj në këtë kontekst kërkoi që për kërkesa të tilla të kemi transparencë dhe anëtarët e kuvendit të njoftohen me kohë.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit – gjithashtu dhe ai kërkoi nga kuvendi që të futet në rend të ditës kërkesa për ofrimin e ndihmës financiare për shërimin e Riza Ibres, i cili ka pësuar një sulm në zemër dhe i cili është i palëvizshëm tash e shtatë javë. Tutje në arsyetimin e kërkesës së tij ceku se Riza Ibra gjendjen ekonomike e ka mjaft të vështirë, andaj në kuadër të kompetencave ligjore të kuvendit bëri thirrje që kjo kërkesë të futet në rend të ditës për shqyrtim dhe e njëjta të aprovohet. Në fund të diskutimit paraqiti vërejtjet e tij që në mbledhjen paraprake të kuvendit shumica e anëtarëve të kuvendit e kanë lëshuar takimin para përfundimit të tij dhe kjo tregon

mungesë të përgjegjësisë dhe përkushtimit në kuvend, gjithashtu kjo vërejtje ju përket edhe drejtorëve të drejtorive, të cilët nuk qëndrojnë në mbledhje dhe nuk përgjigjen në pyetjet dhe çështjet tjera të parashtruara nga anëtarët e kuvendit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - propozoi që në pikën në të ndryshme të diskutohet lidhur me projektin “ndërtimi i palestrës sportive në fshatin Samadrexhë” në kuptimin se kur ky projekt do të fillojë së ndërtuari. Pastaj lidhur me ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike vlerësoi se kjo problematikë është bërë e padurueshme dhe neveritëse dhe për këtë fajet i adresohen KEDS-it, i cili nuk po gjen modalitetet qoftë përmes zgjerimit të rrjetit apo forma tjera që në rastet e defekteve elektrike në një lokalitet të caktuar të mos mbetet i tërë qytetit pa energji elektrike.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës – tha se gati për çdo mbledhje të kuvendit sikur është bërë shprehi që në rend dite të futen kërkesa për ndihmë financiare për shërim, gjë për të cilën askush nuk është kundër, përkundrazi kjo është një gjë shumë e mirë që të ndihmohen këta njerëz. Mirëpo ana negative e krejt kësaj është mungesa e buxhetit të planifikuar dhe se komuna nuk ka mundësi financiare që të gjitha këto kërkesa t’i realizojë për shkak të limitimeve buxhetore. Tutje shtoi se ai kishte me qenë i kënaqur sikur këto kërkesa t’i realizonte në tërësi ndër to edhe kërkesën e Enis Rashicës në vlerë prej 7.000 €, por edhe shumë kërkesa tjera të cilat janë të vazhdueshme. Në vazhdim ai njoftoi kuvendin se që disa vite me radhë komunës sonë në mënyrë lineare i ndahen 182,000.00 € subvencione, dhe për këtë shumë të mjeteve, kuvendi i komunës i orienton se ku do t’i shpenzojë, andaj lidhur me këtë qeveria komunale brenda këtij viti do ta prezantojë një listë para kuvendit për shpërndarjen e këtyre subvencioneve ku një vend i posaçëm do t’i kushtohet ndihmës për shërim. Pastaj ai sqaroi se ato mjete që janë planifikuar për shërim ato edhe të ndahen dhe do të shpenzohen, por nuk ka mundësi ligjore që fondi për subvencione të rritet nga asnjë kategori buxhetore qoftë edhe nga investimet kapitale, kurse kryetari i komunës ligjërisht për këto raste ka të drejt të ndajë mjete financiare maksimalisht deri në vlerën prej 500 €, kurse tani kuvendi nuk ka të drejt që për çdo mbledhje të propozojë shuma të ndryshme për këto raste. Mandej lidhur me kërkesën që drejtorët e drejtorive të jenë prezent në mbledhje vlerësoi se kjo është plotësisht e arsyeshme dhe i bëri me dije se anëtarët e kuvendit ligjërisht kanë të drejtë të ngritin çështje përmes pyetjeve qoftë në formë verbale apo edhe me shkrim, andaj ceku se në mungesë të prezencës së tyre ata kanë obligim që për pyetjet e parashtruara përgjigjet t’i kthejnë me shkrim. Pastaj lidhur me kërkesën për të diskutuar për ndërtimin e palestrës sportive në fshatin Samadrexhë njoftoi se fillimi i ndërtimit të këtij projekti në të vërtetë është zgjat shumë, por tani pritet shpallja e tenderit për këtë projekt duke u bazuar në atë që komuna ka bërë një marrëveshje me ministrinë e linjës që procedurat e tenderimit t’i zhvillojë komuna kurse ministria do t’i derdh mjetet në buxhetin e komunës. Pastaj sqaroi se një projekt të cilin e ka hartuar komuna, lidhur me ndërtimin e palestrës, ministria nuk e ka pranuar dhe ata e kanë bërë një projekt të ri, i cili na është sjell në komunë, dhe tani ka mbetur që Drejtoria e Prokurimit së bashku me ministrinë e linjës të gjejnë modalitetin ligjor për zhvillimin e këtij projekti. Kur bëhet fjalë për ndërprerje të energjisë elektrike nga ana e KEDS-it njoftoi se ka pasur disa takime me ta dhe iu ka parashtruar vërejtjet e tij lidhur me këtë problematikë, por edhe për mënyrën e vendosjes së orëve elektrike, kurse arsyetimi i tyre për ndërprerje të energjisë ka qenë se janë duke punuar në rregullimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së rrjetit elektrik. Në fund tha se kabllot elektrike në sheshin e qytetit do të zhvendosen dhe do të futen nëntokë në bazë të marrëveshjes me KEDS-in dhe këto punime pritët të fillojnë shumë shpejt.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi që kërkesat lidhur me ofrimin e ndihmës financiare për shërim të futen në rend të ditës për shqyrtim dhe të analizohet se a ka mjete financiare a po jo për realizimin e këtyre vendimeve.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 31 vota “për” 2 “abstenime” aprovoi këtë:

RENDITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Draft- Buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2017;
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017;
4. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016;
5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2015/2016 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2016/2017;
6. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore;
7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit dhe pronësisë të pronave të paluajtshme komunale;
8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për emërim të anëtarëve në Komitetin Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini;
9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për emërim të anëtarëve në Komitetin Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike;
10. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për emërim të anëtarëve në Komitetin Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit;
11. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për emërim të anëtarëve në Komitetin Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
12. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për emërim të anëtarëve në Komitetin Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore;
13. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës;
14. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shfuqizimin e vendimit të kuvendit me Nr.150/16 i datës 28.07.2015;
 - b). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit lidhur me ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore
 - c). Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Enis Rashicën.
 - ç). Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Rizah Ibrën.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit – paraqiti vërejtjet e saj lidhur me procesverbalin e mbledhjes së kaluar, ashtu që në faqen 6 ku janë përfshirë diskutimet e saj nuk kemi pasqyrim të drejtë të mendimeve të shprehura, ku ajo ka kërkuar që pagesa e kryetarëve të këshillave të fshatrave të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Pastaj në faqe 22 të procesverbalit “diskutimi i saj siç tha ajo ka qenë” që mjetet financiare që janë ndarë për nder të 2 shtatorit „Ditës së Dëshmorëve”, në këtë rast është dashur që përveç drejtorit të Drejtorisë së Financave të konsultohet edhe drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës¹.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me 32 vota “për” 1 “abstenim” aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.

¹ Vërejtjet dhe plotësimet e propozuara nga anëtarja e kuvendit nuk janë inkorporuar në procesverbalin e mbledhjes së kaluar për shkak se të njëjtat kanë qenë të pabazuara.

2. Shqyrtimi i Draft- Buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2017

Abit Abiti, ZKF – paraqiti sqarime profesionale lidhur me Draft-Buxhetin dhe planet investuese për vitin 2017, duke cekur se në faqen numër 7 shuma totale e shpenzimeve kapitale duhet të përmirësohet nga 4,363,326.00 € në 4,383,326.00 € ky përmirësim nuk paraqet ndonjë implikim buxhetor por është si shumë fiktive. Gjithashtu në faqe nr. 7 projekti menaxhimi i mbeturinave duhet të hiqet nga lista si projekt kapital, në faqe nr. 8 term subvencionim i kamatave duhet të zëvendësohet me termin mbulimi i normave të interesit për bizneset e reja, në faqe nr. 9 pozicioni 31 “asfaltimi i rrugëve në fshatin Reznik lagjet (Mustafa, Curri)” duhet të shtohet edhe lagjja “Makiqi” tek shkolla. Mandej tek shuma e buxhetit për vitin 2018, duhet të futet një projekt i ri që ka implikime buxhetore vetëm për vitin 2018 “ndërtimi i rrugëve në fshatin Druar”, në faqe nr. 11 projekti “ndërtimi i shtatores së Hasan Prishtinës” duhet të riemërohet “ndërtimi i shesheve në qytet”. Gjithashtu nga Drejtoria e Arsimit është futur një projekt i ri “makinë për larjen e enëve” në vlerë prej 3.000€ e kjo shumë zbritet nga projektet e arsimit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - tha se sa i përket shqyrtimit të draft-buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2017, shihet një tendencë e madhe e investimeve në rrugë. Rreth 60 projekte janë vetëm asfalt, ndërsa 30 të tjera kubëza. Ne, në parim nuk jemi kundër ndërtimit të rrugëve, por që ta shpenzosh pjesën më të madhe të parave në tender për rrugë, kjo do të thotë se ky është buxhet që nuk flet shumë për zhvillim. Thjesht është buxhet për vota, buxhet elektorale, e jo buxhet zhvillimor. Qeverisja në Vushtrri edhe njëherë është duke treguar që është qeverisje e interesave personale dhe e tenderëve, por asnjëherë e interesave qytetare dhe zhvillimit ekonomik të Komunës së Vushtrrisë. Gjithashtu duke pasur parasysh që nuk janë inkuorporuar propozimet tona, siç janë: Pagesa e shujtave për nxënës deri në klasë të 5-të. Pagesa e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Vushtrrisë; rritje më të madhe të buxhetit për kulturë, rini dhe sport; rritje më të madhe të buxhetit për bujqësinë etj. Po ashtu propozimi ynë i kamotshëm për së paku një çerdhe të re, edhe pse është planifikuar në këtë draft-buxhet, mendojmë se është gabimisht i planifikuar, sepse është i planifikuar në periudhë kohore 3 vjeçare, që do të thotë që qytetarët duhet të presin mbi 3 vite për një çerdhe të re, kurse ne mendojmë se çerdhja duhet ndërtohet shumë më shpejt duke i pasur parasysh nevojat dhe kërkesat për të. Pra duke e parë mungesën e orientimit të buxhetit në politika sociale që do e rrisnin mirëqenien qytetare, ne, Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk e përkrahim këtë draft-buxhet klientelist."

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit – tha se kur shikohet forma e planifikimit të buxhetit shihet se mjetet financiare të planifikuara dhe të shpërndara në dikasteret komunale ka bërë që drejtorëve iu është mbetur hapësira që të menaxhojnë me këto mjete. Në këtë rrafsh ai ceku se tek projekti i kanalizimeve nuk është bërë precizimi se në cilat pjesë të qytetit do të bëhet ndërtimi i atyre kanalizimeve. Në këtë rast ai propozoi që fshati Pasomë të futet në projekt-buxhet që të bëhet ndërtimi i kanalizimit pasi që ky fshat është në gjendje të keqe sa i përket ujërave të zeza, gjithashtu të futet në projekt meremetimi i shkollës (ndërtimi i pullazit).

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se sa i përket shumave kumulative të inkuorporuar në draft-buxhet për ndërtimin e kanalizimit dhe renovimin e shkollave, këto mjete do të konkretizohen me një vendim të veçantë të kuvendit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se me këtë projekt-buxhet për vitin 2017 është tentuar të preken të gjitha sferat e jetës në komunën tonë, duke iu dhënë prioritet disa segmenteve të caktuara. Tutje shtoi se ajo çka është me rëndësi të theksohet është zhvillimi harmonik i komunës, trajtimi i barabartë i qytetarëve të komunës sonë dhe komunitetet ku jetojnë pa marrë parasysh përcaktimet e tyre të ndryshme politike. Pastaj ai pyeti se sa është participimi apo përqindja e buxhetit në investime kapitale dhe sa është në fushat tjera. Mandej ai theksoi se buxheti duhet të jetë i konkretizuar, për faktin se kjo çështje nuk duhet të mbetet në vullnetin e administratorëve dhe ekzekutuesve dhe se nuk duhet krijuar dilema sa i përket

orientimit dhe konkretizimit të këtyre mjeteve financiare për projektet e caktuara. Mandej për të gjitha këto projekte qoftë segmentet e kanalizimeve, rrugët, shkollat, argjinaturat e lumenjve dhe asfaltimi i rrugëve duhet të konkretizohen hollësisht dhe për të gjitha këto me kohë duhet të njoftohet kuvendi. Pastaj lidhur me të hyrat buxhetore vetanake ku vetëm nga dënimet në komunikacion për vitin 2017 janë planifikuar 11000,735.00 €, dënimet e gjykatave do të jenë 230,000.00 € dhe për këtë pyeti se këto planifikime a janë reale apo jo nëse bëjmë krahasime me vitin që jemi. Prandaj vlerësoi se duhet të kemi planifikim real të të hyrave dhe t'i orientojmë përpjekjet tona në borxhet e këqija dhe që nga këto borxhe gjejmë burime financiare edhe për projekte tjera të reja. Pastaj theksoi se nëse në vitin 2013 kemi pasur mbi 2.000.000 € borxhe të këqija tani ato kanë shkuar vetëm duke u rritur, dhe për këtë duhet të kemi një angazhim të përgjithshëm për t'i inkasuar këto borxhe. Në fund ripërsëriti se duhet të bëhet konkretizimi i projekteve dhe ato të orientohen në vendet ku qytetarët ka nevojë me qëllim të ngritjes së kualitetit të jetesës për qytetarët tanë.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – tha se duke shikuar buxhetin e përgjithshëm për vitin 2017 në vlerë prej 15.902.353.00 € dhe duke u munduar që të jepë edhe unë kontributin tim, konsideroj se disa shërbime do të duhej të kishin më shume mjete të planifikuara. Në këtë rast tek investimet kapitale për vitin 2017 në faqen 10 te shërbimit e shëndetësisë primare tek pajisjet medicinale janë planifikuar vetëm 9327.0 €, mendoj se janë jashtëzakonisht pak kur kemi parasysh gjendjen dhe nevojat e qytetarëve. Tek planifikimi urban dhe mjedisi prapë nuk shoh se është futur asfaltimi i rrugës në fshatin Gumnishtë, lagjja „Ismajli”, pavarësisht premtimeve nga kryetari i komunës dhe drejtoria përkatëse se ky asfaltim do të bëhet për shkak se aty ende ka banorë dhe në dimër ndodh shumëshpesh që ata bllokohen nëpër shtëpitë e tyre për shkak të rrugës. Konsideroj se atyre po u bëhet e padrejtë sepse banorët e asaj lagjeje ishin ata që participuan më së shumti për projektin fillestar i cili ishte bërë në atë kohë. Në faqe 9 gjithashtu tek planifikimi urban dhe mjedisi nr. 14 shkruan asfaltimi i rrugëve në fshatra kërkoi një sqarim se për cilat fshatra bëhet fjalë? Në faqe 9 tek bujqësia ku thuhet subvencionimi i kamatave (projekt 3 vjeçar), si është e menduar kjo formë, nga hulumtimi që kam bërë, kjo formë e subvencionimit nuk ekziston as në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe as në Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë? Po ashtu kërkoi sqarime nga drejtoria për të hyrat vetanake se si e kanë vlerësuar dhe matur që për vitin 2017/2018 dhe 2019 rritjen e të hyrave në buxhetin e komunës dhe a besojnë se kjo rritje do të jetë e tillë sesi është paraqitur.? Në ligjin e Menaxhimit të Financave Publike neni 49 për grante dhe subvencione, paragrafi 49.1 thotë se: përveç në rastet e përcaktuara në nenet 50 dhe 54 të këtij ligji asnjë organizatë buxhetore, autoritet publik ose ndërmarrje e kontrolluar publike nuk duhet të bejë një marrëveshje të çfarëdo lloji në të cilën përfshihet huazimi i parave, zgjatja e një huadhënie ose vendosja e një kredie.

Mirjeta Salihu, anëtare e kuvendit – propozoi që në Draft- Buxhetin e komunës për vitin 2017 të futet kërkesa e banorëve të fshatit Pasomë për ndërtimin e kanalizimit, kërkesë e cila i është parashtruar Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë për Urbanizëm.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit – tha se nga tabela e draft buxhetit te nr. i punëtorëve te zyra e kryetarit më duket një nr. shumë i madh 23. Ne e dimë se kryetari i ka dy vozitës ose (një vozitës dhe një truprojë) por kishim pas dëshirë ta shohim organogramin e zyrës së kryetarit me përshkrimin vendeve të punës . Pastaj te Drejtoria për menaxhimin e katastrofave me kod të programit 18468 në bazë të tabelës 1.7.7 shihet se kemi vetëm 4 punëtorë. Ne e dimë se ju do të thuani se në kuadër të kësaj drejtorie janë edhe zjarrfikësit edhe pse në bazë të tabelës 1.7.6 shihet se zjarrfikësit kanë kod të programit të veçantë 18428 dhe krejt këto kanë mundur me qenë në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike ashtu si i keni shënuar te tabela e investimeve kapitale për Drejtorinë e Shërbimeve publike. Tek investimet kapitale kemi shumë vërejtje sepse për çdo vjet te Drejtoria për Shërbime Publike vetëm pozicioni 13 Ndërtimi i rrugëve me kubëza është specifikuar me emra se cilat rrugë do të shtrohen , kurse te shumica e pozicioneve kemi të investimeve të paspecifikuara si p.sh: furnizimi me gypa të

ujërave të zeza, ndërtimi i kanalizimit, ndërtimi i urave etj, ku nga terreni kemi shumë vërejtje që këto po keqpërdoren duke iu dhënë vetëm militantëve partiak të partisë në pushtet, prandaj ne kërkojmë që në komisionin që mbikëqyr këto punë dhe furnizime të futet edhe një anëtar i opozitës. Tek Drejtorja e Bujqësisë po ashtu kemi shumë vërejtje për donacionet që po u jepen vetëm njerëzve të partisë në pushtet dhe kërkojmë që të sillet në kuvend lista e përfituesve të donacioneve për këtë vit. Tek raporti mbi situatën ekonomike dhe financiare shihet se kemi një kamuflim të shpenzimeve duke paraqitur në tabelë vetëm shpenzimet e përgjithshme sipas drejtorive dhe jo edhe shpenzimet sipas kodeve ekonomike ku do të shiheshin se në cilat kode kemi shpenzime të paarsyeshme dhe të rritura. Te shpenzimet sipas kategorive ekonomike te kategoria e pagave kemi një tejkalim të shpenzimeve të realizuara në krahasim me shpenzimet e planifikuara për afro 75.000.00 euro. Kërkojmë sqarim si ka ardhur deri te kjo situatë

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit – duke iu referuar faqes 8 të Draft-Buxhetit për vitin 2017 ku taksat e qytetarëve do të shkojnë për financimin e projektit “subvencionimi i kamatave” vlerësoi se kjo është shkelje morale, njerëzore dhe ligjore. Pastaj ajo shtoi se shuma prej 100,000.00 € do të ishte mirë që t’i ndahen bizneseve dhe prodhuesve bujqësor si ndihmë e drejtpërdrejt për faktin se këta prodhues kanë nevoja të mëdha. Andaj në këtë kontekst propozoi që mjetet e propozuara për projektin “subvencionimi i kamatave” në vlerë prej 100,000.00 € të dedikohen për projektin “Përkrahja e bizneseve të reja dhe ekzistuese me pajisje”. Tutje tek faqja numër 11 kodi i programit arsimit dhe shkenca propozoi që të futet si projekt rregullimi i shkollës “Nami Frashëri” (të rregullohen dyert, dritaret dhe muri), të bëhet rregullimi i oborrit të kësaj shkolle pasi në të kemi grumbullim të ujërave dhe gjatë ditëve më shi oborri është me baltë, gjithashtu ka nevojë që ndërtohet një depo për vendosjen e thëngjillit pasi që thëngjilli zakonisht vendoset në fushën e sportit në oborrin e kësaj shkolle.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - tha se duhet që në Draft-Buxhetin për vitin 2017 gjërat mos të mbesin të përgjithësuara por ato duhet të konkretizohen, ku secilit projekt duhet ti caktohet emri dhe të dihet vendi se ku po investohet, ku do t’i shmangeshim dilemave për ndërrim të projekteve dhe keqpërdorimeve eventuale qoftë edhe politike siç mund të mendohet, por edhe siç ka ndodhur në të kaluarën. Tutje vlerësoi se buxhetit për vitin 2017 nuk është buxhet zhvillimor, i cili nuk mundëson një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik siç pretendohet nga qeveria komunale. Pastaj pyeti se përse disa projekte janë emëruar kurse disa tjera jo, si për shembull të paspecifikuara kanë mbetur rrugët e rendit të IV, pastaj nuk dihet se në cilat lokalitete do të bëhet rregullimi i kanalizimeve dhe këto lokalitete duhet të precizohen, ndërtimi i parqeve të dihet se ku do të bëhen ato parqe, ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni të specifikohet se cilat rrugë do rregullohen me kubëza, pastaj cilat ura do të ndërtohen. Po ashtu tek kodi ekonomik bujqësia dhe pylltaria, projekti “rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave” edhe këtu duhet të dihet se për cilët lumenj do të rregullohen. Mandej tek planifikimi mjedisor dhe inspektimet ripërsëriti se është hera e tretë që kërkohet rregullimi i rrugës në lagjen “Xhaferi” në fshatin Dobërllukë ku, kjo rrugë është e rëndësishme e cila lidh shumë familje (shtëpi), në këtë kontekst nëse do të rregullohej kjo rrugë do të mundësohej ndërtimi i urës në drejtim të fabrikës së Llamkosit. Shërbimet e shëndetësisë primare projekti “Meremetimi i QMF-së në Lumadh” pyeti se mjetet financiare prej 9,327.00 € për pajisje mjekësore a janë të dedikuara për QMF-në në fshatin Lumadh. Kurse lidhur me ndërtimin e objektit të Shtëpisë së Kulturës me një kosto prej 526,800.00€, për këtë vlerësoi se para dy viteve kur ishte propozimi që kjo qendër të rinovohet të rrënohet apo të shkohet në bashkëfinancim atëherë kostoja e renovimit ishte 600,000 € kurse 1,280.000 € ka qenë ndërtimi i kësaj qendre, dhe tani shtrohet pyetja se çfarë ndryshoi lidhur me koston e këtij projekti a bëhet fjalë për objekt më të vogël apo për çfarë bëhet fjalë. Tutje tek administrata, projekti ndërtimi i shkollave fillore është dashur të bëhet precizimi se cilat shkolla do të ndërtohen. Në fund ai njoftoi se grupi kuvendar i LDK-së që tri vite kërkon që të bëhet rregullimi i shtratit të lumit “Podrança” dhe rregullimi i

rrugës kryesore në fshatin Dobërllukë, andaj nëse edhe këtë herë nuk futen në buxhet këto dy propozime ata do të votojnë kundër draft-buxhetit komunal për vitin 2017.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit – kërkoi që në draft-buxhetin komunal për vitin 2017 të futet si projekt ndërtimi i lapidarit për Sadri Maksutin dhe Skënder Malën, të cilët në vitet e 90-ta kanë dhënë jetën e tyre për atdhe. Ai njofton se nëse kërkesa e tij nuk përfshihet në buxhet vota e tij do të jetë kundër buxhetit komunal për vitin 2017.

Tasim Gubetini, anëtar i kuvendit – tha se edhe për kundër faktit se draft-buxheti për vitin 2017 nuk është gjithëpërfshirës ai do të votojë “për” këtë buxhet. Në këtë relacion ceku se për 17 vite më radhë nuk është investuar në fshatin Nadakoc dhe dëshmon se ai nuk është “person lokalist” për këtë vlerësoi se lokalizmi në gjuhën financiare nënkupton abuzim me paranë publike.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit – tha se asfaltimi i rrugës në fshatin Brusnik, vazhdimisht në planifikime buxhetore ka hyrë për të ardhmen dhe asnjëherë ajo rrugë nuk u rinovua. Tutje shtoi se për shkak të vonesave tona, ajo rrugë është dëmtuar tej mase dhe intervenimi për ta rregulluar është i natyrës urgjente. Pastaj në arsyetimin e saj ceku se nuk është e vërtetë që në atë fshat jetojnë pak familje dhe vlerësoi se rregullimi i saj rrugë do të ndikojë në parandalimin e migrimit dhe zbrazen e atij fshati. Në anën tjetër duke e përkrahur propozimin e anëtarës së kuvendit znj. Sylja, tha se gjendja në shkollën fillore “Naim Frashëri” nuk është e mirë, andaj renovimi i kësaj shkolle duhet të jetë prioritet dhe të futet në buxhetin e vitit 2017.

Agim Bregaj, anëtar kuvendit - prezantoi një kërkesë për ndërtimin e një ure që lidh varrezat me tri fshatra dhe atë Stanoc i Poshtëm, Stanoc i Epërm dhe Lumadh, ai njoftoi se kjo kërkesë është parashtruar nga banorët e këtyre tri fshatrave dhe si e tillë duhet të futet në buxhetin e vitit 2017.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit – tha se është e natyrës urgjente rregullimi i rrugës në lagjen „Dautaj” në fshatin Pasomë, pasi në këtë lagje është duke u eksploatuar shkëmbi ku gjatë këtij procesi janë shkaktuar shumë dëme për banorët e kësaj lagje (është shkatërruar rruga, shtëpitë janë dëmtuar dhe në atë lokalitet shkaktohet shumë pluhur gjatë shfrytëzimit të atij guri që përdoret si material për ndërtimin e rrugëve).

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit – kërkoi që në draft-buxhetin e komunës për vitin 2017 të futet projekti për rregullimin e rrethojës së shkollës në fshatin Lumadh, si dhe të bëhet rregullimi i oborrit të kësaj shkolle.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit – e përkrahi propozimin e anëtarit të kuvendit z. Rrahim Ajeti për futjen në projekt-buxhet për vitin 2017 ndërtimin e lapidarit për Sadri Maksutin dhe Skënder Malën, si projekt dyvjeçar.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se të gjithë jemi në dijeni për një kërkesë të kahershme për hapjen e rrugës në fshatin Kurillovë që lidhet me fshatin Bozhlan e cila është e një gjatësie 300 deri në 400 metra dhe e cila ka mbetur pa u rregulluar, në arsyetimin e tij ceku se ndërtimi i kësaj rrugë do të ndikonte në parandalimin e migrimit të atyre banorëve. Pastaj një kërkesë tjetër mjaft më rëndësi është edhe rregullimi i rrugës në lagjen “Ferizi” dhe “Hajdari” në fshatin Brusnik ku kjo rrugë do të mund të rregullohet si rrugë e rendit të IV në ç’ rast do të bëhej e kalueshme si për shtëpitë ashtu edhe për punimin e tokave. Në këtë kontekst ai kërkoi nga kuvendi që këto dy kërkesa të futen në projekt-buxhetin për vitin 2017. Në fund tha se burimet financiare për ndërtimin e këtyre dy rrugëve duhet të gjenden në mjetet e painkasuara të taksave komunale të cilat komuna duhet t’i inkasojë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës – tha se gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të komunës për vitin 2017, janë organizuar gjithsej 16 dëgjime buxhetore, është mbajtur mbledhja e veçantë nga Komiteti për Politikë dhe Financa e organizuar dhe financuar nga OSBE-ja, në ç’ rast është krijuar një hapësirë e mirë për prezantimin e kërkesave për futje në buxhet, si dhe i është dhënë mundësia subjekteve politike që t’i prezantojnë propozimet e tyre. Tutje ai vlerësoi se nuk aludon që ky planifikim buxhetor është më i miri i mundshëm, dhe njoftoi se në

planifikimin e buxhetit ka pasur mbështetje edhe nga GIZI, dhe me këtë kishte apeluar që të nxirret përqindja e përfshirjes së kërkesave të qytetarëve në projekt-buxhetin e komunës për vitin 2017, kjo deri më tani nuk është bërë sepse kjo çështje do një angazhim, por megjithatë pjesa absolute e këtyre kërkesave të qytetarëve, por edhe të anëtarëve të kuvendit janë përfshirë në buxhet. Pastaj ai theksoi se prej 4,383,326.00 € sa janë planifikuar si investime kapitale është e pamundur që të gjitha kërkesat e qytetarëve të përmbushën, dhe njoftoi se për shkak të mungesës së mjeteve disa projekte janë planifikuar si projekte dyvjeçare. Në këtë kontekst u shpreh se projekti trevjeçar për ndërtimin e rrugës së "Shalës" përkatësisht rruga nga fshati Skromë në drejtim të fshatrave Bozhlan, Vesekoc deri në Kurillovë dhe ky projekt vitin e ardhshëm përfundon. Mandej duke iu përgjigjur anëtarit të kuvendit z. Shabanit njoftoi se rruga e rendit të IV-të në fshatin Kurillovë do të përfundohet, kurse në të ardhmen kjo rrugë do të shtrohet në asfalt. Lidhur me kërkesat e anëtarëve të kuvendit për specifikimin e projekteve të përfshira në draft-buxhet si p.sh rrugët e rendit të IV-të, mandej trotualet dhe kanalizimet, por edhe subvencionet, për këto çështje ai u zotua se për të gjitha këto projekte do të formohet lista e cila do t'i ofrohet kuvendit për aprovim. Mandej për ndërtimin e lapidarëve është bërë projekti që një lapidar do të ndërtohet në fshatin Stroc, dhe në kuadër të këtyre mjeteve do të ndërtohet edhe lapidari për Sadri Maksutin dhe Skënder Malën. Rregullimi i shkollës në fshatin Lumadh është si projekt dhe në kuadër të kodit ekonomik "rregullimi i shkollave" edhe kjo në kuadër të një propozimi të drejtorisë do të merret vendimi në kuvend për përfundimin e këtij projekti. Për ura janë ndarë 25,000.00 € dhe edhe për këtë do të vendosë kuvendi në sajë të vendimit për konkretizimin e këtyre projekteve. Lidhur me çështjen e ngritur nga anëtari i kuvendit z. Ali Januzi, njoftoi se i është adresuar me një shkresë Komisionit për Miniera dhe Minerale, dhe përgjigjja e këtij komisioni është marrëveshja e lidhur mes dy kompanive është e pavlefshme dhe me sa është në dijeni licenca këtyre kompanive iu është marrë, kurse lidhur me riparimin e rrugës njoftoi se nesër ka do ta zhvillojë një takim me Kompaninë "Rrukolli" dhe se zyrtarisht kanë filluar procedurat për kryerjen e këtij projekti. Rruga në fshatin Brusnik do të trajtohet si rrugë e rendit të IV-të, kurse shkolla fillore "Naim Frashëri" do futet si projekt dhe do të përfundojë renovimi i saj. Pastaj vlerësoi se nuk pajtohet me anëtarin e kuvendit z. Gubetini se në fshatin Nadakoc nuk është investuar, për faktin se atje shumë rrugë lokale janë përfunduar, kurse e papërfunduar deri në fund ka mbetur një rrugë që lidh fshatin Nadakoc me fshatin Pestovë për shkak se përfundimi i kësaj rruge ka një kosto ofro 500.000.00 €, ndërsa kanalizimin dhe ujësjellësin do të mundohemi që vitin e ardhshëm të trajtohen. Rruga në lagjen "Xhaferi" është e planifikuar si projekt dyvjeçar. Rregullimi i shtratit të lumit "Podrança" nuk është anashkaluar asnjëherë por kësaj here nuk është projektuar dhe për këtë do të tentohet të gjendet ndonjë donacion, që vitin e ardhshëm të ndërtohet edhe ky projekt. Mandej lidhur me ndërtimin e objektit të Shtëpisë së kulturës, njoftoi se për vitin e ardhshëm ministria ka ofruar 350,000.00.00 €, për renovimin e atij objekti, kurse ideja jonë është që ky objekt të rrenohet dhe më këto mjete të ministrisë dhe duke participuar edhe ne si komunë të ndërtohet një objekt i ri. Lidhur me vlerësimet e bëra nga grupi kuvendar i LDK-së dhe i VV-së se buxheti është jozhvillimor ceku se secili i përfaqëson idetë e veta, por duhet pasur parasysh se nëse është rritur buxheti për subvencionimin e bujqësisë prej 330,000.00 € në 400,000.00 €, kjo tregon se ky buxhet është megjithatë buxhet zhvillimor, andaj subvencionimi i bujqësisë, si dhe rregullimi i infrastrukturës rrugore duke përfshirë edhe „Rrugën e Shalës” që shkon brezit të fshatrave Bajgorë, Vesekoc, Kurillovë dhe që përfundon në fshatin Barilevë Komuna e Prishtinës (rrugë kjo që mendohet të financohet nga ministria dhe është rrugë që lidhë disa komuna). Çështja e projektit për subvencionim të kamatave, është kërkuar që bëhet ndryshimi i emërimit të këtij projekti dhe të emërtohet "Ndihmë për bizneset". Lidhur me zhvillimin ekonomik, njoftoi se ka kërkuar nga Ministria e Bujqësisë që të bëhet një linjë buxhetore për zhvillimin e komunave, kurse lidhur me projektin për subvencionimin e kamatave tha se do të shikohet se çfarë efektesh do të japë në të ardhmen dhe do të vlerësohet nga niveli qendror se kjo metodë e subvencionimit a është ligjore apo jo. Realizimi i këtij projekti në vlerë prej

100,000.00 € mendohet se do të gjenerojë të hyra prej 1.000.000 € dhe do të realizohet përmes procedurave të tenderimit në ç' rast do të përzgjidhet operatori ekonomik (banka) e cila do ketë kamatat më të ulëta për akordimin e kredive për bizneset e komunës sonë.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – tha se në Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike neni 49 për grante dhe subvencione, paragrafi 49.1 thotë se: përveç në rastet e përcaktuara në nenet 50 dhe 54 të këtij ligji asnjë organizatë buxhetore, autoritet publik ose ndërmarrje e kontrolluar publike nuk duhet të bëjë një marrëveshje të çfarëdo lloji në të cilën përfshihet huazimi i parave, zgjatja e një huadhënie ose vendosja e një kredie. Andaj lidhur me këtë çështje vlerësoi se projekti “Subvencionimi i kamatave për bizneset” nuk është i paraparë askund në ligj dhe për këtë duhet të gjendet një zgjidhje tjetër brenda suazave të ligjit.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - tha se në kodin ekonomik te planifikimi mjedisor dhe inspektimi, kemi kamuflim politikë për shkak se projekti asfaltimi i rrugëve në fshatin Dobërlukë, lagjja “Xhaferi -Merovci”, këtu bëhet fjalë për dy shtëpi përkatësisht fjala është për dy militantë të partisë në pushtet (PDK) që iu shtrohet rruga, dhe është kamufluar se po ndërtohet rruga në lagjen “Xhafer-Merovci” kur dihet fakti se lagjja “Xhaferi” ka më tepër se 25 shtëpi.

Tasim Gubetini, anëtar i kuvendit – tha se për rrugën që është ndërtuar është bërë në fshatin Mavraj, kurse rrugët anësore në fshatin Nadakoc janë të pashtuara, kurse shkolla është ndërtuar nga mjetet e ministrisë dhe mund të thuhet se nga mjetet e tatimpaguesve vushtrrias nuk kemi asnjë investim për 17 vite me radhë në fshatin Nadakoc.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës - duke iu përgjigjur anëtarit të kuvendit z. Hysni Gërgurit, ceku se tek kodi ekonomik planifikimi urban dhe mjedisi, projektet me numër rendor 1-6 janë projektet të vitit të kaluar që kanë qenë dyvjeçare që janë aprovuar në kuvend dhe për të cilat tani kemi obligime, ato tani janë duke u zhvilluar dhe pritet të përfundojnë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –në rekapitullimin dhe rezymenë e debatit lidhur me draft-buxhetin komunal për vitin 2017 e hodhi në votim këtë dokument me ndryshimet e propozuara nga qeveria komunale, si dhe me ato ndryshime që kryetari i komunës i mori parasysh gjatë diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve të kuvendit e të cilat nuk kanë implikime buxhetore në kufijtë e përgjithshëm buxhetor.

Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për”, 9 vota “kundër” të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve kapitale për vitet 2017-2019, konform Qarkoreve Buxhetore 01/2017 dhe 02/2017 të lëshuara nga MF-ja.

2.Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017 është 15,902,353.00 €, prej të cilave për:

• Paga dhe mëditje.....	9,532,316.00 €.
• Mallra dhe shërbime.....	1,562,755.00 €.
• Shpenzimet komunale.....	241,042.00 €.
• Subvencione.....	182,914.00 €.
• Shpenzime kapitale.....	4,383,326.00 €.
Githsejt:.....	15,902,353.00 €.

3.Të hyrat vetanake të planifikuara.....2,316,735.00 €.

4.Mjetet financiare të cekura në piken 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me Qarkoren Buxhetore 2017/02 të MF-së në bazë të kufijve të dhënë.

5.Për zbatimin e këtij Vendimi do të obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente.

6.Tabela 4.1- Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2017, Tabela 4.2 – Investimet kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2017-2019, Tabelën 4.3 janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

3.Shqyrtimi i Draft-Rregullore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime lidhur me Draft-Rregulloren për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017, duke parashtruar të dhëna dhe statistika lidhur me pronat që janë objekt i tatimit.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - tha se si grup kuvendar LDK-së pajtohen me ndarjen e zonave tatimore, si dhe me tarifat që janë përcaktuar me këtë rregullore dhe pyeti se për cilat sipërfaqe të tokave bujqësore bëhet fjalë, dhe propozoi që tokat bujqësore të cilat punohen të lirohen nga ngarkesat e tatimit në pronë, me qëllim që të stimulohet punimi i tokave.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se herën e kaluar Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ka prezantuar të dhëna mjaft të vlefshme sa i përket tatimit në pronën e paluajtshme. Tutje shtoi se në saje të investimeve të përgjithshme që janë bërë në pjesë të ndryshme të qytetit është ndryshuar kualiteti i jetesës në kuptimin pozitiv të fjalës. Investimet që janë bërë sidomos në pjesën e qytetit nga vendi i quajtur ura e hekurit e deri tek Stacioni i Autobusëve duke përfshirë rrugën, kanalizimin, ujësjellësin, sipërfaqe të gjelbëruara dhe ndriçimi, kanë ndikuar në përmirësimin e kualitetit të jetesës për këta qytetarë. Në këtë relacion ka qenë e udhës që kjo pjesë e qytetit të ketë një trajtim tjetërfare. Mandej ai shtoi se tani ne do ta aprovojmë këtë rregullore, por me një kërkesë që drejtoria përkatëse të kryejë obligimet e veta ligjore në verifikimin e pronës së paluajtshme ndërtimore ashtu siç e parasheh ligji që 1/3 e pronës të verifikohet brenda vitit, gjë të cilën edhe auditori i brendshëm e ka kontestuar se nuk është kryer, të gjitha këto çështje duhet të bëhen me qëllim të rritjes së të hyrave komunale.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së – dha sqarime profesionale duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit ku ceku se pronat bujqësore nuk janë objekt i tatimit në pronën e paluajtshme. Kurse lidhur me pyetjen e z. Muharrem Shabani ceku se Ligji për tatimin në pronën e paluajtshme i ka përcaktuar koeficientët dhe ata koeficientë nuk e kemi parë të arsyeshme t'i paraqesim në rregullore, sepse ligjërisht komuna ka të drejtë të përcaktojë rregulla në dy pozicione dhe atë: sa i përket vlerës së tregut dhe përcaktimit të zonave. Në fund ai tha se ndryshimet që janë propozuar nga anëtarët e KPF-së dhe të kuvendit janë inkorporuar në këtë draft-rregullore.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se lidhur me këtë draft-rregullore ka pasur propozime si nga anëtarët e KPF-së ashtu edhe nga anëtarët e kuvendit. Por vlerësoi se çështja ka ngelur sepse nuk ka pasur një organizim të mirë nga ana e vetë drejtorisë për t'i kryer punët dhe obligimet të cilat i takojnë. Pastaj ai shtoi se në bazë të ligjit, drejtoria ka qenë e obliguar jo vetëm në fund të këtij viti por çdoherë në baza kalendarike me datë 31.12 të çdo viti, të caktojë vlerën reale të çdo objekti d.m.th vlerën reale e jo vlerën imagjinare. Propozimi tjetër i dhënë më herët nga ana e tij ka qenë që zonat tatimore të përcaktohen konform vlerës reale të tregut sa i përket objekteve ndërtimore, gjë e cila aktualisht nuk mund të thuhet se është bërë dhe këtu kemi një vlerësim jo real të këtyre pronave. Në këtë kontekst theksoi se probleme ka sidomos tek zona e parë e cila kategorizohet me një çmim të njëjtë si në hapësirën ku metri katror për lokale afariste është shembull 3.000 € ashtu është edhe tek lokalet afariste ku vlera reale e tyre është p.sh 500 €, dhe kjo na sjellë deri tek përfundimi që e hedh poshtë konstatimin e drejtorisë se nuk ka pasur propozime lidhur me këtë dokument. Mandej vlerësoi se kërkesa e drejtorisë për formimin e një komisioni të përbashkët mes drejtorisë dhe kuvendit nuk është e arsyeshme

për faktin se këto detyra dhe obligime janë të zyrtarëve të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa. Kjo rregullore edhe vitin e kaluar është rregulluar me të njëjtin tekst pa pasur ndryshime. Mandej në këtë rregullore fare nuk është përcaktuar rregulli për vlerën e zhvlerësimit të pronës, gjë e cila është kategori dhe obligim ligjor, kur dihet mirëfilli fakti se vlera fillestare e një objekti është tjetër, kurse vlera e po të njëjtit objekt pas një viti është tjetërfare. Andaj për të gjitha këto çështje ai ka biseduar me drejtorin e drejtorisë por sipas tij një gjë të tillë nuk e "përkrah programi", kurse prej vitit të ardhshëm do të bëhet integrimi i programit dhe do të fillojë të llogaritet vlera e zhvlerësimit të objekteve sepse kjo është kategori ligjore dhe është obligative që të zbatohet. Në fund tha se duhet të aprovohet kjo rregullore për faktin se nuk ka një zgjidhje të dytë për momentin, por e gjithë kjo me një kusht që drejtoria vërtet të mobilizohet dhe të formojë komisionin për hartimin gjegjësisht zoonimin sipas vlerës së tregut në mënyrë që çdo qytetarë të paguajnë atë se çka i takon dhe në të njëjtën kohë mos të dëmtohen qytetarët, por të paguajnë për atë çka e posedon dhe jo për atë çka nuk posedon. Rregullorja në formën çfarë e kemi sot sigurisht që ndokënd e dëmton për faktin se nuk kemi vlerësime sipas vlerës së tregut.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 27 vota "për", tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

1. Aprovohet Rregullorja mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3. Ky Vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

4. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese në gjashtë mujorin e parë të vitit 2016

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se raporti për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016, paraqet punën dhe aktivitetet e qeverisë komunale gjegjësisht aktivitetet e kryetarit të komunës, të cilat janë të pasqyruara në mënyrë të saktë si në përshkrim ashtu edhe në formë tabelore, aktivitetet e punës të cilat janë kryer sipas planeve investuese të parapara dhe konform dinamikës. E gjithë kjo konsideron se jep një pasqyrë të drejtë, të plotë dhe transparente për anëtarët e kuvendit dhe qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Përmes pasqyrave përmbledhëse janë paraqitur në mënyrën më të mirë të mundshme përshkrimi, kodi, periudha raportuese, planifikimi, realizimi në periudhën raportuese. Nga gjithë sa u tha, konsideron se kryetari i komunës në përgjithësi ka realizuar për këtë periudhë raportuese kualifikimin buxhetor në vlerën e kënaqshme gjegjësisht afër 80 %, dhe nëse merren për bazë edhe ato projekt që janë në realizim e sipër kemi një planifikim dhe realizim të mirë të projekteve. Gjithashtu vlen të theksohet se planifikimi i të hyrave i cili sipas këtij raporti paraqet një sukses sepse arrin vlerën e inkasimit gjegjësisht të realizimit 93 %. Nëse i referohem punës së drejtorive komunale shihet se kemi një përmbushje shumë të lartë mes planifikimit dhe realizimit. Në fund tha se nëse dëshirojmë të bëjmë një rekapitullim të punëve të kryera atëherë del se kryetari i komunës ka bërë një punë shumë të madhe në të mirë të qytetarëve, ku janë realizuar projektet konform planifikimit dhe atë çdoherë ka mbizotëruar transparenca për shpenzimin e çdo "cent" të parasë publike.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se pajtohet pjesërisht me parafolësin e tij se kemi të arritura, por disa shifra që janë prezantuar në këtë raport nuk na bëjnë të jemi të kënaqur kur nuk kemi ndryshime pozitive. Pastaj ceku se nëse buxheti deri në këtë kohë është realizuar në masën 77 % dhe investimet kapitale i kemi të realizuara në masën prej 48 % me këtë nuk

mundem të jemi të kënaqur për faktin se nuk kemi ndryshime brenda kësaj etape kohore. Në këtë kontekst nevojitet një mobilizim për realizimin e buxhetit. Tek procedurat e prokurimit shihet se nga 40 projekte 13 prej tyre nuk iu janë zhvilluar procedurat e prokurimit ku shprehur në përqindje 67% , kurse 32% e projekteve nuk i është iniciuar procedura për zhvillimin e projekteve. Çështje tjetër që mbetet e hapur është shfrytëzimi i pronës komunale kur realizimi është në masën 51% e të hyrave të planifikuara. Një dukuri tjetër e cila na preokupon të gjithëve është mbrojtja e pyjeve, ku që disa vite po konstatohet gjendja e njëjtë, dhe në këtë drejtim nuk kemi ndonjë risi qoftë në ripyllëzim. Është shumë e nevojshme që kontratat e dhënies së pronës në shfrytëzim të menaxhohen më mirë, mandej menaxhimi më i mirë i pronave të uzurpuara, ku që sa kohë nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë. Gjithashtu si shumë të nevojshme shprehu aplikimin e kursimeve, ku ceku se nuk mund të ketë arsytim ku vetëm për këtë gjashtëmujor për servisim të automjeteve kemi 51,740.00€ dhe kjo është një shumë mjaft e madhe. Në këtë relacion nëse kostoja e një veture të blerë nga Drejtoria e Arsimit ishte 13,000.00 €, atëherë shumë më mirë do të ishte që me këto mjete të sevisimit të automjeteve të blihen 4 apo 5 vetura të reja. Duke iu referuar raportit dhe përformacës së auditorit të përgjithshëm del se komuna jonë është prej komunave që i ka shpenzimet më të larta në telefonin mobile, në karburante në litra për 100 km. Një tjetër element i cili duhet të shikohet shuma prej 34,000.00 € për shërbimet hoteliere për këtë gjashtëmujor. Mandej gjithashtu të analizohet shuma prej 26,000.00€ për artikuj ushqimor në dy baza në objektin në Lumadh. Pastaj në mënyrë taksative me shkrim kërkoi të informohet nga Drejtoria e Financave, për listat mbi pagesat e tatimit në pronë sipas vendbanimeve të identifikohet se sa është përqindja, dhe të dihet se ky kriter apo merret për bazë në caktimin e prioriteteve në orientimin e projekteve kapitale, pastaj lista e obliguesve të tatimit në firmë, si dhe shumën e borxheve të këqija. Element tjetër mjaft me peshë është kualiteti i punëve të kryera, ku ka mjaft ankesa dhe vërejtje se rrugët e asfaltuara brenda dy muajve po dëmtohen dhe për këtë duhet të adresohet përgjegjësia. Kanalizimi i bllokuar nga shembja e një ure tek lagjja “Gërxfhalu” ka shkaktuar ndotje dhe kundërmim nga ujërat e zeza dhe apeloj që për këtë problem të gjendet një zgjidhje. Lidhur me raportin për situatën ekonomiko- financiare, vlerësoi se sikur të lë përshtypjen se ky raport është një plagjiaturë nga raportet e mëhershme, ku illustroi shembull se këtë vit jemi në tetëvjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, kurse në faqen 20 të këtij raporti thuhet gjashtëvjetori i shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, këto gjëra kërkoi të përmirësohen.

5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2015/2016 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2016/2017

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – ngriti shqetësimin e tij lidhur me transportin e nxënësve në mënyrë të organizuar (me kombi), ku ai kishte pasur një përshtypje jashtëzakonisht të keqe ku në një kombi barten deri në 36 nxënës kur dihet fakti se në kombi mund të barten 15 persona. Lidhur me këtë çështje ai pyeti drejtorin e Drejtorisë së Arsimit sa është në dijeni për këtë dhe cilat masa i ka ndërmarr. Madje ai pyeti se përse për nxënësit e fshatit Tërllobuq nuk organizohet transporti, të cilët udhëtojnë deri tek shkolla e fshatit Pasomë ku rruga është bukur e gjatë dhe e dëmtuar.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit - tha se sipas mendimit të saj kjo pikë e rendit të ditës nuk duhet të paraqitet si shqyrtim i informatës sepse nga praktikat e deritanishme informatat nuk shqyrtohen. Duke e lexuar këtë informatë për përfundimin e vitit shkollor 2015/2016 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2016/2017 dhe gjithmonë duke marrë parasysh se organizimi i procesit edukativo arsimor nuk është i lehtë dhe ka vështirësitë e veta, shoh se me shumë është një informatë e cila në vete nuk përmban çështje përmbajtësore të nevojave dhe sfidave në shkollat tona. Kjo informatë më shumë është një përmbledhje e gjendjes statistikore. Konsideroj se kjo informatë do të duhej që të përmbante disa çështje të cilat i kam potencuar edhe herën e kaluar, por nuk kam marrë asnjëherë përgjigje.

Pyetje këto të cilat do t'i paraqes prapë me shpresën se drejtorja ne fjalë do të sjellë përgjigje:

1. Cili është vlerësimi i performancës së drejtorëve të shkollave?
2. A ka shkollë më ushtrues detyre të drejtorit?
3. Pse kemi ende shkolle pa emër dhe nuk vendoset për emrin?
4. Sa është numri i orëve të humbura nga ana e mësimdhënësve?
5. Sa është numri i mësimdhënësve që jepin lëndët dhe nuk janë adekuat për atë lëndë?
6. Cilat masa disiplinore janë marrë deri tani për nxënësit ose mësimdhënësit ?
7. Cila është cilësia e ekskursioneve, transparenca e shpenzimeve sidomos në Shqipëri?

Me shpresën që këtë herë të marr përgjigje prej pyetjeve të mia. Prapë konsideroj së paku për shumicën e shqetësimeve të mia do të duhej të debatohim pas një raporti të gjendjes reale në shkollat tona. Dhe krejt kjo me qëllim që të kemi një arsim më cilësor dhe në nivelin që ka nevojë qyteti ynë. Dhe meqë jemi tek Drejtorja e Arsimit kërkoj nga drejtori një informatë me shkrim për disa mësues të cilët janë punësuar muajt e fundit, të dimë për emrat e tyre dhe mbi të gjitha për kualifikimet e tyre dhe emrin e universitetit, për shkak të dyshimit se janë punësuar si mësimdhënës edhe ata që kanë përfunduar nëpër kolegjet private dhe jo në universitetet publike. Duke e marrë parasysh se Ligji për Arsimin ndalon punimin e të gjithë atyre që janë të kualifikuar nëpër kolegjet të punojnë në arsim edhe pse unë jam kundër kësaj neglizhence ndaj kolegjeve private por që z. drejtor ligji e ka përcaktuar kështu dhe askush nuk është mbi ligjin. Këtë kërkesë e bëj për shkak të disa ankesave se disave as nuk iu ka lejuar aplikimi në ato konkurse, të cilat ju i keni hapur e disa kanë aplikuar dhe janë pranuar si mësues.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - paraqiti brengën e tij për siç tha se në arsimin e mesëm të lartë në gjymëvjetorin e parë rezultati negativ shprehur në përqindje është 61% ose 2032 nxënës, kurse në gjysmëvjetorin e dytë gjendja ndryshon në kuptim të kalueshmërisë në 216 nxënës ose 6.1%. Andaj duhet bërë një pyetje logjike se a thua i kemi nxënësit aq të aftë që të përmirësohen për dhjetë herë nga 61% në 6.1% për një periudhë kaq të shkurtër, apo i kemi aq të përgatitur mësimdhënësit për një kthesë kaq të madhe thuaj të pabesueshme. Andaj konform këtyre pyeti drejtorin e arsimit se a është bërë ndonjë analizë se ku qëndron problemi tek mësimdhënësia apo tek nxënësit, apo ekziston ndonjë problem tjetër për një sukses kaq të dobët.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit - irduke ju referua informatën në fjalë, ceku se Drejtorja e Arsimit me datën 19.07.2016 ka shpallur konkursin e rregullt për vendet e lira të punës, për gjithsej 25 vende në mësim klase dhe 1 vend në mësim lënde. Për mësim klase kanë konkurruar 175 kandidatë, ndërsa për mësim lënde 12, ku ceket se për mësim klasor ishte vetëm një kandidat i kualifikuar, kurse për mësues lënde ishte vetëm 1 kandidat i kualifikuar me kualifikim master. Andaj kërkoj nga Drejtorja e Arsimit që të paraqesë sqarime që për 25 vendet e shpallura dhe për një vend mësim lënde a janë plotësuar vendet e shpallura dhe me çfarë kualifikimi janë plotësuar, pasi që në informatë ceket se vetëm një kandidat është i kualifikuar për mësim klasor. Gjithashtu kërkoj që DA-ja të njoftoj se a ka mësimdhënës të pakualifikuar që punojnë dhe nuk iu është shpallur vendi i punës.

Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së - paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit. Ai nuk e kontestoi faktin se në bartjen e nxënësve në mjetin e transportit (kombi) barten më tepër se 30 nxënës, por sqaroi se këtë transport nuk e organizon Drejtorja e Arsimit por ai mund të jetë i organizuar nga vetë prindërit. Çështja e bartjes së nxënësve të fshatit Tërllobuq, nuk është bërë për faktin se me ligj është e precizuar që nxënësve do t'u sigurohet transporti në rastet kur gjatësia e transportit është mbi 4 km dhe që në rastin konkret kjo distancë nuk ekziston. Dhe njoftoi se data 1 shtator nuk do të ketë transport për asnjë shkollë për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Lidhur me çështjen e suksesit të nxënësve ceku se nëse është analizuar me kujdes raporti i drejtorisë për gjysmëvjetorin e dytë, atëherë del se ai nuk ka qenë i njëjtë me këtë që po e trajtojmë tani, sepse edhe në fund të gjysmëvjetorit të dytë ka pasur nxënës që kanë mbetur në riprovim dhe në gjysmëvjetorin e parë nuk mund të thuash se një nxënës ka kaluar nëse ka mbetur me një notë të dobët kështu që arsyeshëm del që kjo diferencë më shumë është për shkak të

neglizhencës së nxënësve, të cilët nuk kanë angazhim të mjaftueshëm në semestrin e parë. Pastaj lidhur me çështje e pranimit të kuadrove mësimore sqaroi se prej 25 pozitive të mësuesve klasorë vetëm 1 ka qenë i diplomuar, ndërsa të tjerët janë ata që kanë punuar edhe viteve të kaluara sepse në mungesë të diplomuarve dikush duhet të punojë me nxënës dhe beson se më të përgatitur janë ata mësimdhënës të cilët kanë punuar edhe më herët. Kur bëhet fjalë për lëvizjet e mësimdhënësve prej një shkolle në tjetrën kjo gjë ligjërisht është e lejuar me qëllim të adresimit dhe përmbushjes së nevojave të shkollave.

6. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se fushata e korrje-shirjeve ka përfunduar me sukses, dhe ceku se gjatë mbjelljeve vjeshtore duhet pasur kujdes lidhur me farërat që po vinë në territorin e vendit tonë, ku në shumë raste po kemi dështime për shkak të kualitetit të këtyre farërave, pastaj plehrat e ndryshme që gjithashtu nuk janë kualitative, andaj lidhur me këtë problematikë apeloj tek organet e inspektorit komunale dhe qendrore që të kenë kujdes të veçantë.

7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit dhe pronësisë të pronave të paluajtshme komunale

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se pasi për këtë pikë të rendit të ditës është dhënë opinioni i Zyrës ligjore, atëherë ai propozoi që në rastin e vendosjes lidhur me këtë çështje të ndiqen procedurat ligjore në bazë të ligjeve në fuqi.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2016, pas shqyrtimit të Propozim-Vendimit për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit dhe pronësisë të pronave të paluajtshme komunale nga Shtëpia Ndëshkuese Përmirësuese (Burgu i Smrekonicës), Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë i parashtron këtë:

Rekomandim

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që në rastin e vendosjes për kthimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe të pronësisë lidhur me pronat komunale të sipër cekura, t’i zhvillon procedurat ligjore konform Ligjit për Kadastrin Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës dhe akteve tjera nënligjore që i rregullojnë fushën e të drejtës pronësore që i referohen pronës komunale.

8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për emërim të anëtarëve në Komitetin Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - tha se e vlerëson punën e panelit përzgjedhës për intervistimin e kandidatëve për anëtarësim në komiteteve konsultative dhe ceku se kishte me qenë mirë që për çdo anëtar të këtyre komiteteve të kemi nga një CV. Pastaj ai theksoi se shumica e këtyre anëtarëve janë të ri në moshë, gjë e cila i bënë këta persona të papërvojë, kurse përvoja në këto komitete është shumë e domosdoshme. Në fund kërkoi që pikat që kanë të bëjnë më komitetet konsultative të votohen në pako (tërësi).

Bajram Mulaku, kryetar i komunës – tha se kuvendi i komunës ka formuar komisionin i cili është marrë me zhvillimin e procedurave të rekrutimit për anëtarët e këtyre komiteteve konsultative, dhe qeveria komunale në asnjë rast nuk është implikuar në këtë proces gjë e cila ndoshta edhe mund të kualifikohet si gabim.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini, në këtë përbërje:

- 1.1 Arta Gashi;
- 1.2 Besart Duraku;
- 1.3 Raif Lahu;
- 1.4 Alban Bajrami;
- 1.5 Xhejlane Krasniqi;
- 1.6 Jeta Haxhaj;
- 1.7 Agon Maxhuni.

2 Komiteti Konsultativ në përbërje të cekur si në pikën paraprake do t’i ushtrojë kompetencat dhe funksionin e tij konform dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimin Administrativ 2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna.

3. Komiteti Konsultativ në fjalë, në mbledhjen e parë të tij do të emërojë Kryesuesin dhe zv. kryesuesin, për të udhëhequr mbledhjet e komitetit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini, Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për emërim të anëtarëve në Komitetin Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike në këtë përbërje:

- 1.1 Valmire Sinani;
- 1.2 Adelina Ibrahimiq;
- 1.3 Hasan Maxhuni;
- 1.4 Xheneta Berisha;
- 1.5 Emin Salihu;
- 1.6 Ylberina Murseli;
- 1.7 Fitore Behrami.

2. Komiteti Konsultativ në përbërje të cekur si në pikën paraprake do t’i ushtrojë kompetencat dhe funksionin e tij konform dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimin Administrativ 2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna.

3.Komiteti Konsultativ në fjalë, në mbledhjen e parë të tij do të emërojë Kryesuesin dhe zv. kryesuesin, për të udhëhequr mbledhjet e komitetit.

4.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike, Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

10.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për emërim të anëtarëve në Komitetin Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit, në këtë përbërje:

- 1.1 Naser Maliqi;
- 1.2 Leonora Ibrahimimi;
- 1.3 Fatmire Krasniqi;
- 1.4 Blerim Maxhuni;
- 1.5 Lulzime Zeneli;
- 1.6 Gentiana Shala;
- 1.7 Xhafer Bajrami.

2.Komiteti Konsultativ në përbërje të cekur si në pikën paraprake do t'i ushtrojë kompetencat dhe funksionin e tij konform dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimin Administrativ 2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna.

3.Komiteti Konsultativ në fjalë, në mbledhjen e parë të tij do të emërojë Kryesuesin dhe zv. kryesuesin, për të udhëhequr mbledhjet e komitetit.

4.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Komiteti Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit, Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

11.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për emërim të anëtarëve në Komitetin Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, në këtë përbërje:

- 1.1 Kadri Maxhuni;
- 1.2 Saim Berisha;
- 1.3 Sabrie Gashi;
- 1.4 Behar Duraku;
- 1.5 Saranda Krasniqi;
- 1.6 Lumturije Ismajli;
- 1.7 Xhavit Ahmeti.

2.Komiteti Konsultativ në përbërje të cekur si në pikën paraprake do t'i ushtrojë kompetencat dhe funksionin e tij konform dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimin Administrativ 2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna.

3.Komiteti Konsultativ në fjalë, në mbledhjen e parë të tij do të emërojë Kryesuesin dhe zv. kryesuesin, për të udhëhequr mbledhjet e komitetit.

4.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Komiteti Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

12.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për emërim të anëtarëve në Komitetin Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit Konsultativ për Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, në këtë përbërje:

- 1.1 Violeta Paci Nura;
- 1.2 Hilmi Vllahija;
- 1.3 Adelina Sadiku;
- 1.4 Elfate Karaça;
- 1.5 Fitore Beqiri;
- 1.6 Fuad Kasumi;
- 1.7 Dafina Fazliu Ademi.

2.Komiteti Konsultativ në përbërje të cekur si në pikën paraprake do t'i ushtrojë kompetencat dhe funksionin e tij konform dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimin Administrativ 2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna.

3.Komiteti Konsultativ në fjalë, në mbledhjen e parë të tij do të emërojë Kryesuesin dhe zv. kryesuesin, për të udhëhequr mbledhjet e komitetit.

4.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Komiteti Konsultativ për Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

13.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës;

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit – propozoi që afati i dhënies në shfrytëzim të kësaj prone të jetë 7 vite, kurse çmimi fillestar propozoi të jetë 100 €.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës – tha se kjo pikë e rendit të ditës ka qenë edhe më herët në kuvend, por e njëjta nuk ka kaluar dhe për këtë është kërkuar opinion i ministrisë së linjës lidhur me ligjshmërinë e këtij propozim-vendimi. Pastaj ai vlerësoi se kërkesa për konsultim paraprak me ministrinë e linjës nuk është përgatitur si duhet dhe si rezultat i vlerësimit negativ nga ana e ministrisë përkatëse kjo çështje ka dështuar që të aprovohet. Tutje ai njoftoi se ky projekt ka të bëjë me komunën dhe Unionin Evropian në vlerë prej 500,000 €, dhe sqaroi se në një nen të kontratës shkruan se në rast të dështimit të këtij projekti komuna ka për obligim që

kthimin e mjeteve në vlerën prej 500.000€. Projekti në fjalë është duke u zhvilluar në ç'rast janë blerë pajisjet, është ndërtuar objekti, kurse në bazë të kontratës jemi të obliguar që të formojmë një ndërmarrje sociale, por kemi problem se Ligji për Ndërmarrjet Sociale nuk është aprovuar. Për implementimin e këtij projekti është formuar një OJQ dhe kjo është bërë nga kompania "Rea", andaj në bazë të kontratës jemi të obliguar që të njëjtës OJQ t'i japim në shfrytëzim këto prona për 5 vite, ku dy vitet e para financimi ndodh prej projektit, kurse për tri vitet tjera punëtorët do të paguhet nga të hyrat që gjeneron kjo ndërmarrje. Dhe tani kemi ardhur në një gjendje ku do të shpallet një ankand dhe nuk dihet se kush e merr dhe në këtë formë rrezikojmë që këta punëtorë të mbesin pa punë. Ligji që ishte premtuar se do të aprovohet nuk kemi sinjale se do të bëhet, andaj në këtë formë rrezikojmë të bëjmë ndonjë gabim të madh që në instancë të fundit komunës do t'i kushtojë shumë, dhe propozoi që kësaj OJQ-je t'i jepet kjo pronë në shfrytëzim edhe për 3 vite dhe pas kësaj periudhe i merret në tërësi kjo pronë dhe përfundon ky proces.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se nëse kërkesa për konsultim paraprak për ligjshmërinë e kësaj çështjeje ka shkuar gabimisht nga Sekretaria e Kuvendit, atëherë qeveria komunale mund të kërkojë sërish interpretim ligjor sa i përket kësaj çështjeje në Ministrinë e Pushtetit Lokal. Tutje shtoi se kuvendi mundet të pret derisa kjo çështje të kthehet nga ministria përkatëse, dhe tani të merret ky vendim për faktin se askush nga kuvendi nuk është i interesuar që të dëmtohet financiarisht komuna. Në fund ai tha se kuvendi ligjërisht nuk ka të drejtë që në mënyrë të njëanshme të jep pronë në shfrytëzim.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës ligjore - tha se në këtë propozim-vendim është e udhës që të shtohet edhe një pikë e veçantë ku do të specifikohet qëllimi i dhënies së kësaj prone në shfrytëzim, për faktin se një gjë të tillë e kërkon ligji.

Arta Haxhaj, drejtoreshë e DEBPZHR-rë - tha se kjo çështje ka shkuar për interpretim në ministrinë përkatëse dhe në bazë të përgjigjes së marrë jemi të obliguar ligjërisht që kjo pronë të jepet në shfrytëzim përmes procedurave të ankandit. Tutje shtoi se në bazë të kontratës komuna ka obligim kontraktues që kësaj OJQ-je t'i japë këtë pronë në shfrytëzim. Pastaj ajo ceku se ky projekt ka dimension ambiental, por ndikon edhe në aspektin e punësimit ku ceku se këto ditë do të nënshkruajnë marrëveshje me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ku do të angazhohen 15 persona në punë në afat tremujor. Në fund tha se pasi që kemi marrë përgjigje nga ministria, atëherë kjo çështje të vazhdohet me procedurat e ankandit dhe të përfundojë ky proces.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës ligjore - tha se kërkesa për interpretimin e kësaj çështjeje është bërë me kërkesën e kuvendit dhe ka kaluar përmes Sekretarisë së Kuvendit.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se për këtë propozim-vendim kishte ekzistuar pajtimi që i njëjti të aprovohet, por tani dolën në shesh shumë çështje për të cilat ai nuk kishte qenë në dijeni, ndër të tjera se komuna paska marrëveshje me Unionin Evropian se në rast dështimit duhet t'i kthejë mjetet financiare në vlerë prej 500.000€. Investimi i bërë është 187.000.000€ dhe të merret obligimi që në rast dështimi duhet të kthehen 500.000€, mendon se kjo nuk është e drejtë dhe për këtë pyeti se a është marrë mendimi i Zyrës ligjore kur është nënshkruar kjo kontratë. Pastaj vazhdoi duke njoftuar se ai nuk ka paka qenë i njoftuar se a është marrë mendimi i Zyrës ligjore kur është vendosur të formohet ndërmarrja sociale e cila ligjërisht nuk mund të regjistrohet në Republikën e Kosovës, nuk e ka ditur që ka bord kjo OJQ. Andaj çështja është se atë bord kush e ka formuar, ku organizatat komunale nuk mund të përfaqësohen pa qenë pjesë edhe anëtarët e kuvendit. Në këtë formë anëtarët e kuvendit po sillen në lajthitje edhe përkundër faktit se ka ekzistuar vullneti që kjo çështje të shtyhet përpara. Në fund tha se për këto dhe shumë çështje tjera, nuk do të merrë fare pjesë në votim më konkretisht vota e tij do të jetë kundër, për faktin se në fund të fundit si anëtar i kuvendit do të akuzohet se ka dëmtuar financiarisht komunën në vlerë prej 500.000 €, dhe vlerësoi se edhe përzgjedhja e OJQ-së, është bërë në kundërshtim me rregullat ligjore.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se ne si anëtarë të kuvendit kemi drojën se komuna me këtë proces është duke “sharruar” në obligime financiare ndaj subjekteve tjera në shumën deri në 500.000 €, në rastin më të keq nëse nuk zbatohet kontrata në fjalë. Andaj në këtë rast kërkoi nga drejtoria që një kopje e asaj marrëveshjeje t’u dërgohet të gjithë anëtarëve të kuvendit, të bëhet e ditur se kush është pjesë e atij bordi, pastaj të njoftohemi se kush është palë dhe nënshkruar i asaj kontrate. Në fund tha se duhet të jemi syhapur që mos të pranojmë obligime të cilat më vonë do ta rendojnë buxhetin e komunës por, të ndiqet ana ligjore në raste të futjes në obligime kontraktuese.

Tasim Gubetini, anëtar i kuvendit – kërkoi sqarime lidhur me atë se tani jemi duke bërë shkelje ligjore për faktin se kjo pikë e rendit të ditës është votuar në mbledhjen e kaluar të kuvendit dhe tani kjo çështje nuk mund të diskutohet për faktin se për këtë është marrë vendimi.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës – duke folur për partneritetin në fushën e ndërmarrësisë me Komunën e Växjö të Suedisë njoftoi kuvendin se shteti i Suedisë akoma nuk e ka të aprovuar Ligjin për ndërmarrjet sociale, ndërsa i kanë të themeluara me qindra ndërmarrje sociale siç po pretendon që edhe komuna jonë ta themelojë një të tillë. Në këtë kontekst arsyetoi se themelimi i një ndërmarrjeje të tillë është një veprim njerëzor dhe human i shtetit që e themelon ku në shumë raste në këto ndërmarrje punësohen njerëz me aftësi të kufizuara dhe në këtë rast qëllimi i ndërmarrjes sociale, do të shërbente për menaxhimin e mbeturinave me të cilat komuna jonë ka mjaft probleme. Pastaj ai ceku se këto para janë të Unionit Evropian, kurse me vlerën prej 50.000 € participon komuna dhe në rastin konkret procedurat i ka udhëhequr Unioni Evropian nëpërmes kësaj OJQ-je e cila ka pasur rol në implementimin e këtij projekti. Sipas kontratës si komunë kemi pasur për obligim të caktojmë një menaxher ku në këtë pozitë është caktuar Arta Haxhaj. Në fund tha se ka punuar shumë që ky projekt të realizohet dhe ceku se nëse është vullnet i kuvendit që ky projekt të futet në konkurrencë, atëherë le të veprohet në këtë formë.

Arta Haxhaj, drejtoresh e DEBPZHR-rë- tha se ky projekt është paksa i komplikuar pasi ligjet tona në shumë raste nuk korrespondojnë me ato të Bashkimit Evropian, por pasi është marrë ky projekt atëherë ky projekt duhet të përfundohet, me qëllim që të jetë projekt i qëndrueshëm dhe i suksesshëm. Kur bëhet fjalë për bordin atëherë duhet cekur se ky bord funksionon pa pagesë dhe ka për detyrë që ta përcjellë situatën dhe i cili në vete ka njerëz të shoqërisë civile. Në fund tha se pas konsultave dhe opinionit të Ministrisë së Pushtetit Lokal ky projekt duhet të bëhet përmes procedurave të ankandit publik dhe duke u zhvilluar konkurrenca.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se nuk duhet të krijohet imazhi se kuvendi është duke i bllokuar projektet, por ne vetëm dëshirojmë që t’i respektojmë procedurat ligjore, dhe apeloj se nëse ka vullnet hartuesi i këtij propozimi mund të konsultohet sërish me ministrinë e linjës.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës – rikujtoi faktin se kuvendi vite më parë ka aprovuar një vendim për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale në fshatin Bukosh ku edhe është ndërtuar kjo qendër për grumbullimin e letrës, andaj propozoi që ky projekt të aprovohet që të dalë në ankand përmes konkurrencës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për”, 1 votë “kundër” tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër me kompensim të pronës së luajtshme dhe të paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, në kohëzgjatje prej 7 viteve si vijon:

1.1. Pjesa e ngastrës kadastrale nr. 70202010-00210-0, në sipërfaqe prej 01.00.00 ha (10000 m²), Zona Kadastrale Bukosh, e përcaktuar si lokacion për ndërtimin e qendrës për grumbullimin, selektimin dhe paketimin e letrës dhe plastikës, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës 01nr.196/14, dt.29.09.2014.

1.2. Objekti i ndërtuar në pjesë të parcelës së cekur në pikën paraprake në sipërfaqe prej 410 m² (katërqind e dhjetë metra katror).

1.3.Pajisjet: një makinë transportuese shpërndarëse (Pikap kamionetë) në vlerë prej 23,482 €, një kamion për grumbullimin e mbeturinave në vlerë prej 48,380 €, një shirit transportues në vlerë prej 2,500 €, dy peshore matëse në vlerë prej 1,500 €, një vinç i motorizuar në vlerë prej 14,500 €, një vinç manual në vlerë prej 780 € dhe katër makina balluese në vlerë prej 15,200 €. Vlera totale prej 106,342 € (njëqind e gjashtëmijë e treqind e katër dhjetë e dy euro).

1.4.Kontejnerët 1.1 m³ - (njëqind copë) në vlerë prej 21,300 € (njëzet e njëmijë e treqind euro).

2.Pronat e komunës të cekura si në pikën 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim me kompensim,

2.1.Çmimi fillestar është 100 € në vit (njëqind euro);

2.2.Të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me lokalitë të bartësve përfituesi i ankandit.

2.3.Komuna rezervon të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës, nëse një gjë të tillë e parasheh interesi i përgjithshëm. Në këtë rast komuna duhet ta njoftoj shfrytëzuesin së paku tridhjetë (30) ditë para ndërprerjes së kontratës.

3.Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronave komunale të cekura në pikën 1 të këtij vendimi është që operatori ekonomik përfitues i të drejtës së shfrytëzimit pronave, të ushtrojë veprimtarinë ekonomike për grumbullimin, selektimin dhe paketimin e letrës dhe plastikës.

4.Obligohet Komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale që të zhvillojë procedurat për shpalljen e ankandit si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimit të të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

14.Të ndryshme

a). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shfuqizimin e vendimit të kuvendit me Nr.150/16 i datës 28.07.2015

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota "për" të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01Nr.150/16 i datës 28.07.2016, lidhur me autorizimin e kryetarit të komunës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe Spitalit Sheykh Zayde në Vushtri.

2.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Sekretaria e Kuvendit.

b). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit lidhur me ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota "për" të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

1. Lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale: nr.P-70202063-00155-0, me kulturë arë e klasës së 6 (gjashtë), në sipërfaqe prej 1000m² të marrë nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës që është 4925m² Zona Kadastrale Strovç, pronë e Mehmet (Osman) Aliu me vendbanim në fsh.Strovç Komuna Vushtrri.

2. Qëllimi i lejimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi është ndërtimi i hangarit për vendosjen e mjeteve bujqësore.

3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirë për ndërtimin e objektit nga pika 2 e këtij Vendimi do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij Vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 nën "b" të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Në vazhdim kuvendi i komunës vendosi që bashkërisht t'i shqyrtojë këto dy pika të rendit të ditës:

c). Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Enis Rashicën;

ç). Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Rizah Ibrën;

Bajram Mulaku, kryetar i komunës – tha se kemi mungesë të mjeteve financiare dhe ceku se ajo çka mund të bëhet është që maksimalisht t'i ndajmë nga 1000 € për secilin person. Tutje shtoi se fondi për subvencione është i limituar dhe nëse ne i ndajmë këto mjete atëherë për rasteve tjera nuk do të mund t'u ofrojmë ndihmë.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se edhe kur është bërë planifikimi i buxhetit, kishte kërkuar që të rritet buxheti për ofrimin e ndihmës për shërim. Tutje shtoi se ekziston rregullorja e brendshme për subvencionimin e njerëzve të sëmurë për barna dhe shërim, dhe në këtë rregullore është e përcaktuar se më shumë se dy vite radhazi një person nuk mund të subvencionohet. Andaj për këtë është mirë që të formohet një Data-Bazë ku do të evidentoheshin këta persona. Në vazhdim vlerësoi se duhet të kemi kujdes në shpenzimin e këtyre mjeteve, dhe bëri thirrje që për vitin e ardhshëm nga fondi për subvencione të rritet vlera e mjeteve për ofrimin e ndihmës për shërim. Lidhur me rastin e Enis Rashicës i cili vuan nga sëmundja e zemrës, ceku se trajtimi i tij është urgjent dhe është për keqardhje që komuna nuk mund t'i dal në ndihmë.

Avdullah Klinaku, drejtor i DSHMS-së - njoftoi se në fondin për subvencione në buxhetin e Drejtorisë së Shëndetësisë, aktualisht ka vetëm 50 € kurse mjetet tjera janë shpenzuar.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit – tha se rasti i sëmundjes së Enis Rashicës është mjaft i rëndë dhe apeloj tek drejtoritë kompetente që të gjejnë një zgjidhje që këtij personi ti dilet në ndihmë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës – tha se do të tentohet që të gjenden mjete nga Zyra e kryetarit për realizimin e këtyre kërkesave.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi që për këta dy persona të shikohet mundësia që të gjenden mjete financiare dhe ceku që shuma të jetë nga 1000 € për secilin person.

Në fund të diskutimeve lidhur me këto pika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në vlerë prej një mijë euro (1.000 €) nga buxheti i komunës – fondi për subvencione për Enis/Imer/Rashicen me banim në fshatin Studime e Poshtme, Komuna e Vushtrrisë.

2.Shuma e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të shërimit të sëmundjes së tij.

3.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

1.Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në vlerë prej një mijë euro (1.000 €) nga buxheti i komunës – fondi për subvencione për Riza Ibren me banim në “Rr. Mehdi Hajrizi” në Vushtrri, Komuna e Vushtrrisë.

2.Shuma e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të shërimit të sëmundjes së tij.

3.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

e). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – kërkoi që të informohet me shkrim lidhur me atë se a është bërë pranimi teknik i sheshit “Dëshmorët e Kombit” dhe i rrugës “Skënderbeu” me gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe a janë përmbushur obligimet kontraktuese konform kontratës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

Bastri Duraku


Procesmbajtës


Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit